



## Auktorisoidun kääntäjän tutkinto 12.11.2016

Kielet ja käännösuunta  
albaniasta suomeen

Aihepiiri (aukt2)  
laki ja hallinto

### Käännöstehtävä

Valtakirja, jossa asiakirjan laatija ilmaisee tahtonsa asioidensa hoitamisesta.

Lähde: <http://www.dppm.gov.al/>

Lähde: <http://www.wipo.int/pct/guide/en/gdvol2/annexes/al.pdf>

### Käännöksen käyttötarkoitus

Käytetään aineistona Suomen ja Albanian käräjäoikeudessa valtaoikeuksien käytöstä syntyneessä kiistassa.

*Huom! Käännökseen ei saa kirjoittaa vakuuslauseketta eikä nimeä!  
Vakuuslausekkeen tai nimen kirjoittaminen käännökseen johtaa  
tutkintosuorituksen hylkäämiseen.*

Käännettävän tekstin pituus 2048 merkkiä

## **Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM)**

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave është institucion shtetëror që siguron dhënien dhe mbrojtjen e këtyre objekteve të pronësisë industriale:

- Shpikjeve dhe Modeleve te Përdorimit
- Markave Tregtare dhe të Shërbimit
- Dizeniove Industriale
- Treguesve Gjeografikë
- Topografive dhe Qarqeve të Integruar

Zyra për regjistrimin e markave tregtare ka funksionuar pranë Dhomës së Tregtisë së Shqipërisë që nga viti 1957. Me Ligjin Nr.7819 veprimtaria e Dhomës së Tregtisë i kaloi Zyrës së Patentave dhe Markave e cila u krijua me numrin.135 , nga data 22 Mars 1993. Sot Drejtoria e Patentave dhe Markave (DPPM) është institucion publik në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarjes. Veprimtaria e saj përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin 9947 dt. 07/07/2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) përbëhet nga këta sektorë:

I. Drejtoria e ekzaminimit,

- a) Sektori i patentave,
- b) Sektori i markave

II. Drejtoria e koordinimit, promovimit dhe trajnimeve

III. Sektori i financës, shërbimeve dhe publikimeve

IV. Sektori juridik

Mbrojtja e sistemit të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin kombëtar si edhe Traktatet e Konventat ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare.

### **Veprimtaria Kryesore**

- Administron të gjitha procedurat për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale.
- Kryen regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale si : patenta, marka, dizajno, treguesit gjeografike.
- Harton ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me përsosjen e sistemit të Pronësisë Industriale.
- Përfaqësohet në Gjykatë për çështje që lidhen me administrimin e objekteve të Pronësisë Industriale.
- Përfaqëson vendin dhe plotëson detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe, me zyra homologe dhe organizma e Organizata Ndërkombëtare për çështje të Pronësisë Industriale.

### **Shërbimet**

- Kryen shërbime informacioni për objektet e pronësisë industriale.
- Organizon seminare, për ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e sistemit të Pronësisë Industriale.
- Publikon informacion të specializuar në fushën e Pronësisë Industriale, në buletinin periodik tre mujor.
- Publikon materiale, flete palosje lidhur me sitemin e të drejtave të Pronësisë Industriale.

